



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivered	21. 04 2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SIAMSHCK	2312/2022		114



Republika e Kosovës

• Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.217/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi- kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca- anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.217/2022 të datës 09.03.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë kundër organit të punësimit Komuna e Pejës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 21.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr.217/2022 e datës 09.03.2022, e parashtruar nga ankuesi
- II. Obligohet Kryetari i Komunës së Pejës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij të inicioj veprimet e nevojshme ligjore për harmonizimin e koeficientit të nëpunësit civil nga koeficienti shtatë pikë pesë (7.5) në koeficientin tetë pikë pesë (8.5).
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Pejës, me datë 09.03.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokollit 01-016/01-001885/2022 të datës 22.02.2022 të Kryetarit të Komunës së Pejës, me pretendimin që ti harmonizohet koeficienti i pagës ashtu që edhe ankuesi të barazohet me pozita homologe brenda dhe jashtë institucionit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 1249/2022 të datës 09.03.2022 të parashtruar nga ankuesi

në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër të protokollit 01-016/01-0018851/2022 të datës 22.02.2022 të Kryetarit të Komunës së Pejës; Ankesën me numër protokollit 6352/2021 të datës 28.12.2021 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e ankuesit të datës 11.11.2021 drejtuar Kryetarit të Komunës së Pejës; Formularin për dorëzimin e kërkesës së datës 11.11.2021; Formularët e shpenzimit të Departamentit, Divizionit ose sektorit për planifikimin e vitit 2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 31.12.2021 e parashtruar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë me numër protokollit 225/2022 të datës 18.01.2022, Akt emërimit të ankuesit me numër Nr.01-112-192 të datës 04.01.2012, së bashku me formularin PDP për përshkrimin e detyrave të punës; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2020; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2019; Kartelën e nëpunësit civil-ankuesit; E-mailin zyrtar të datës 03.02.2022 lidhur me provat shtesë të lëndës së ankuesit; Akt emërimit të datës 06.04.2020 për Udhëheqës të Sektorit të Kadastrit, Aktvendimin e datës 09.10.2009 për konfirmim të Akt Emërimit me nr.01-112/01-0153324/19 të datës 2019 për Udhëheqës të Sektorit të Tatimit në Pronë, Akt emërimit të datës 04.01.2012 për Shefe të Zyrës Komonale për Komunitete, Akt emërimit nr.01-112/01-0135586/21 të datës 21.12.2021 të Udhëheqësit të Prokurimit, Aktvendimin me Nr.02-112-5345/2013 të datës 25.07.2013 të Udhëheqësit të Sektorit Administrativo Financiar, Akt Emërimit të datës 04.01.2012 për Udhëheqësin e Sektorit të Financave, Akt emërimit të datës 04.01.2012 për Udhëheqësin e Njesisë Ligjore teknike dhe për leje ndërtim, Akt emërimit të datës 04.01.2012 për Udhëheqësin e Njesisë së Mbrojtjes së Mjedisit, Akt emërimit të datës 04.01.2012 për Udhëheqësin e Njesisë për kushte të lokacionit dhe leje urbanistike, Akt emërimit të datës 04.01.2012 të Shefit të Sektorit për Inspektime Komonale, Akt emërimit të datës 04.01.2012 të Shefit të Sektorit për Shërbime Publike; Akt emërimit të datës 04.01.2012 të Shefit të Zyrës Ligjore, Akt emërimit të datës 04.01.2012 të Shefit të ZKGJC-së, Akt emërimit të datës 02.07.2012; të Shefit të Sektorit Teknik; Akt emërimit të datës 15.03.2012 të Sektorit për Rini; Akt emërimit të datës 04.01.2012 të Shefit të Sektorit për Kulturë, Akt emërimit të datës 31.12.2012 të Udhëheqësit të Sektorit të Shërbimeve Komonale, dhe Akt emërimit të datës 04.01.2012 të Shefes së Sektorit për Bujqësi.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e bazuar sepse:

Nga administrimi i provave të lëndës përkatësisht sipas Akt emërimit me numër 01-112-192 të datës 01.01.2012, Kolegji ka gjetur së ankuesi është i emëruar në pozitën *Shef i Sektorit për Buxhet* në Komunën e Pejës me koeficient 7.5 të pagës. I njëjti me datë 11.11.2021, parashtron kërkesë me numër 01-016/01-122908, adresuar Kryetarit të Komunës së Pejës, Drejtorit për Buxhet dhe Financa, dhe Menaxherit të Personelit, për ngritjen e koeficientit të pagës nga 7.5 në 9, e për të cilën kërkesë ankuesi nuk ka pranuar përgjigje nga organi i punësimit. Pas heshtjes administrative të organit të punësimit lidhur me kërkesën e datës 11.11.2021, ankuesi me datë 28.12.2021, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për harmonizim të koeficientit të pagës nga 7.5 në 9. Këshilli përmes Vendimit me numër A.nr.1224/2021 të datës 10.02.2022 ka obliguar Kryetarin e Komunës së Pejës që ta shqyrtoj kërkesën e ankuesit me numër të protokollit 01-016/01-01-122908 të datës 11.11.2021 lidhur me harmonizimin e koeficientit dhe të nxjerrë akt administrativ në pajtim me dispozitat përkatëse ligjore. Kryetari i Komunës së Pejës, me datë

22.02.2022 ka nxjerrë Vendimin me numër të protokollit 01-016/01-0018851/2022, sipas të cilit e ka refuzuar kërkesën e ankuesit për ngritjen e koeficientit të pagës, kundër të cilit vendim ankuesi brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 19 ku përcaktohet se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave si dhe nenin 3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil me të cilin parashihet se: 1. E drejta e nëpunësve civil për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil. 2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë...., dhe rrjedhimisht konstatoj se e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësit civil të cilët kryejnë detyra të ngjashme të punës dhe që kanë kualifikime dhe përvojën e kërkuar për pozitën respektive, duhet të realizojnë pagë të njëjtë. Andaj, në vështrim të këtyre dispozitave si dhe bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka gjetur se organi i punësimit respektivisht Komuna e Pejës ka aplikuar koeficient të ndryshëm lidhur me pozitat e udhëheqëseve të sektorëve brenda Komunës si pozita të kategorisë së njëjtë të punës, gjegjësisht Kolegji nga provat materiale ka konstatuar se sipas Akt Emërimit të datës 06.04.2020 Udhëheqësi i Sektorit të Kadastrit ka koeficient 8.5 të pagës, Udhëheqësi i Sektorit të Tatimit në Pronë sipas Akt Emërimit të datës 09.10.2020 ka koeficient 9 të pagës, Udhëheqësja/shefja e zyrës së komuniteteve sipas Akt emërimit të datës 04.01.2012 ka koeficient 9.5 të pagës, Udhëheqësi i Prokurimit sipas Akt Emërimit të datës 11.12.2021 ka koeficient 9 të pagës, ndërsa ankuesi në pozitën e Udhëheqësit të Sektorit për Buxhet, ka koeficient 7.5 të pagës. Kështu që bazuar në këto fakte, Kolegji vlerëson se aplikimi i koeficienteve jo të njëjtë të pagës për pozita të kategorive të njëjta, paraqet trajtim jo të barabartë dhe diskriminues të stafit brenda të njëjtit institucion dhe një veprim/mosveprim i tillë i organit të punësimit është në kundërshtim me nenin 3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil si dhe me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi përkatësisht nenin 2 ku përcaktohet se: *Ky ligj zbatohet për të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, ...të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizik dhe juridik, në të gjitha fushat e jetës, e posaçërisht që kanë të bëjnë me:..... 3. kushtet e punësimit dhe të punës, përfshirë shkarkimin apo ndërprerjen e kontratës dhe pagesës; si dhe nenin 4 paragrafi 1 të të njëjtit ligj ku thuhet se: "Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji.**

Nisur nga fakti se ankuesi ka qenë i emëruar në kohën kur ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, Kolegji ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.05/2012 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe rrjedhimisht sipas nenit 14 të kësaj Rregullore pozita udhëheqës i sektorit përcaktohej si pozitë e nivelit drejtues një (1) me gradë shtatë (7) të pagës, duke u evidentuar edhe në Katalogun e Vendeve të Punës (i miratuar me datë 05.02.2015 i ndryshuar dhe plotësuar me 21.08.2018), me Kodin BF/140 dhe gradë 7.

Po ashtu bazuar në nenin 34 paragrafin 3 të Rregullores Nr. 05/2012 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës kanë qenë të detyruar që



të bëjnë klasifikimin, harmonizimin dhe standardizimin e pozitive në pajtim me dispozitat e kësaj rregullore.

Kolegji me rastin e shqyrtimit dhe vendosjes lidhur me çështjen ankimore, mori parasysh shkresën me numër DASHC/MAP-04/1571 02/ZPS/3851 të datës 10.11.2014 të lëshuar nga drejtori i Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/MAP, për Sekretarët e Përgjithshëm, Drejtorët e Agjencive Ekzekutive dhe Menaxherët e Personelit të institucioneve publike përmes të cilës shkresë janë vendosur koeficientët e pozitive përkatëse rrjedhimisht për pozitën Udhëheqës i sektorit është vendosur koeficient tetë pikë pesë (8.5).

Andaj, nisur nga gjendja faktike dhe juridike e konstatuar si më lartë, Kolegji vlerësoj se organi i punësimit gjegjësisht Komuna e Pejës me rastin e mos harmonizimit të koeficientit të pagës së ankuesit ka vepruar edhe kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me të cilin është përcaktuar se: *"Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paañësisë politike, mosdiskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë"*.


Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.


Kolegji pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.217/2022.

Ardita Percaku-Shyti

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Pejës;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Pejës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

